Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0034

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga,Isa Hasani-Kryetar, Vedat Poterqoi-Anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së OE "Gazmend Bojku" B.I., kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pjesë rezerve për autobusë IVECO" me numër të prokurimit TU-23-10152-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A., me datën: 27/03/2024, mori këtë;

Vendim

1.Refuzohet ankesa si e pa bazuar e Operatorit ekonomik ankues "Gazmend Bojku" B.I. me nr. të protokollit 2024/0034, e datës 09/01/2024, kundër aktivitetit prokurimit "Furnizim me pjesë rezerve për autobusë IVECO", me numër të prokurimit TU-23-10152-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A.Prishtinë.

2. Mbetet në fuqi, "Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues" lidhur aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pjesë rezerve për autobusë IVECO.", me numër të prokurimit TU-23-10152-1-1-1.

3. Konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, ndaj operatorit ekonomik ankues, bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 25.09.2023, N.P.K. "Trafiu Urban" SH.A në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pjesë rezerve për autobusë IVECO" me numër të prokurimit TU-23-10152-1-1-1.

Ndërsa me datën 19.12.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE "Profitech SH.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 1,200,000.00 Euro.

Me 26.12.2023, OE "Gazmend Bojku" B.I. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 27.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 09.01.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Gazmend Bojku" B.I. me nr. 2024/0034 lidhur me aktivitetin "Furnizim me pjesë rezerve për autobusë IVECO" me numër të prokurimit TU-23-10152-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Në mbështetje te Rregullore 01/2020 e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit gjegjësisht nenit 13 Dorëzimi i Ankesave paragrafi 9 i nenit 13 kërkohet që "Pretendimet ankimore duhet të jenë te njëjta me ato të paraqitura për autoritetin kontraktues".

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Gazmend Bojku" B.I.

Pretendimet e OE ankues: "1.AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së fillimisht duke na penguar me metodat e tij të kundërligjshme rreth afateve kohore dhe kërkesave diskriminuese të dosjes së tenderit e tani së fundmi edhe duke mos na dhënë qasje në dokumentacionin e tenderit. Pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, ne kemi kërkuar qasje në dokumentet e tenderit në përputhje me nenin 10 të LPP-së por që AK nuk na e ka mundësuar një qasje të tillë. Ne kemi dërguar edhe disa kërkesa për qasje duke i sqaruar AK-së se po vepron në kundërshtim me nenin 10 dhe 11 të LPP-së gjë të cilën ja kemi dëshmuar edhe me fakte ligjore, por kjo e fundit prap nuk e ka respektuar kërkesën tonë dhe në kundërshtim me çdo normë ligjore për transparencën dhe llogaridhënien përpara palëve të interesuara, nuk na e ka mundësuar qasjen e kërkuar.

Sipas kësaj del që veprimi i AK-së për mos lejim të qasjes në dokumentet e tenderit përpos që përkon me shkeljen e nenit 10 dhe 11 të LPP-së, veprimi i tillë është edhe diskriminues ndaj neve dhe favorizues ndaj OE që e ka shpallur fitues që përbën shkelje të plotë të nenit 7 të LPP-së.

2. AK ka shkelur nenin 10 të LPP-së kur neve nuk na e ka dhënë mundësin e qasjen në dokumentet e tenderit edhe pse kemi dorëzuar disa herë kërkesë për qëllimin e tillë. E themi këtë sepse sipas nenit 10 të LPP-së thuhet qartë se me kërkesë të një OE të interesuar, Autoriteti Kontraktues do të sigurojë qasjen e kërkuar në mënyrë të rregullt, të 5/8 qetë, dhe pa pengesa gjë të cilën AK nuk na e ka mundësuar. Tek nenin 11 i LPP-së shumë qartë thuhet se cilat kushte duhet të plotësohen për tu cilësuar një informatë e caktuar si konfidenciale, kushte të cilat nuk janë plotësuar nga kërkesa e OE "Profitech" SHPK. Për të qenë më korrekt po i paraqesim kushtet e tilla drejt për drejtë nga ligji Pika 11.3.1 dhe pika 11.3.3 nuk janë plotësuar nga kërkesa për sekret afarist e dërguar nga OE "Profitech" SHPK dhe përpos kësaj, kërkesa përmban edhe dokumente që nuk bien tek nenin 68 dhe 69 i LPP-së, si dhe nuk është ofruar deklarata me shkrim me të dhënat e kërkuara tek pika 3.3 e nenit 11 të LPP-së. Vlen të ceket se sipas nenit 11.3.1 të LPP-së vetëm dokumentet e përcaktuara nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 68 ose

69 të këtij ligji mund të konsiderohen sekret afarist ndërsa AK pa asnjë bazë ligjore ka mbajtur si të tilla komplet dosjen e tenderit të këtij OE.

Pavarësisht nga kërkesa e OE që dokumentet e caktuara të mbeten sekret afarist, është AK ai i cili duhet të vendos në përputhje me nenin 11 të LPP-së se cilat nga dokumentet mund të pranohen si sekret afarist. AK nuk e ka bërë fare këtë analizë por pa asnjë të drejtë ligjore ia ka konsideruar të gjithë tenderin e këtij OE si sekret afarist. Se kur duhet të pranohet një kërkesë e OE për konfidencialitet lidhur me dokumentet e tenderit e sqaron edhe Interpretimi 31 i KRPP-së të cilin AK nuk e ka respektuar fare. Për pasojë të kësaj ne nuk kemi mundur të informohemi me përgjegjshmërinë apo jo të tenderuesve dhe për shkeljet e mundshme të shkaktuara nga AK mbi bazën e të cilave do të parashtronim kërkesë për rishqyrtim me pretendime të tilla andaj me të drejtë konstatojmë se AK ka shkelur plotësisht nenin 10 të LPP-së.

3. AK ka shkelur nenin 11 të LPP-së pasi që fillimisht në kundërshtim me paragrafin 3 të këtij neni e ka pranuar kërkesën për konfidencialitet si të rregullt edhe pse ajo nuk i plotëson dy nga tre kushtet e këtij neni. Më pas në kundërshtim të plotë me paragrafin 3.1 të nenit 11 të LPP-së ka mbajtur si sekret afarist edhe dokumente që nuk bien në grupin e dokumenteve të kërkuara nga AK sipas nenit 68 dhe 69 të LPP-së. AK ka vepruar në kundërshtim të plotë edhe me paragrafin 4 dhe 5 të nenit Neni 11 i LPP-së sepse nuk e ka përgatitur fare versioni e pastruar të dokumenteve të cilat më pas do duhej të na ofroheshin neve sipas kërkesës për qasje në dokumentet e tenderit. Paragrafi 4 i nenit 11 të LPP-së e detyron AK-në që të përgatitë versionin e pastruar të secilit 6/8dokument të tillë dhe të i jepet qasje OE-së që e kërkon qasjen në ato dokumente. Këtë nuk e ka bërë AK dhe shihet hapur që ka vepruar plotësisht në kundërshtim me nenin 11 të LPP-së. Bazuar në krejt këtë po shihet hapur se AK nuk ka veruar aspak sipas ligjit kur neve na ka refuzuar qasjen në dokumentet e tenderit të OE që ishte shpallur fitues andaj si përgjigje ndaj kësaj po i drejtohemi OSHP-së me ankesë. Në këtë ankesë kemi dhënë mbështetjen e mjaftueshme ligjore mbi bazën e të cilës besojmë se OSHP do ta aprovoj si ankesë të bazuar dhe të veproj në përputhje të plotë me ligjin dhe dispozitat që i përshkruajnë situatat e tilla. Nga krejt kjo dhe me arsye të plotë konstatojmë se AK ka shkelur plotësisht nenin 11 të LPP-së.

4. Ne dyshojmë se AK ka shkelur edhe nenin 59 të LPP-së me vet faktin që po i frikohet transparencës së veprimeve të veta dhe qëllimisht është duke fshehur informatat që ligjërisht duhet të jenë publike. Me vet faktin që nuk na ka ofruar asnjë të dhënë rreth procedurës së prokurimit dhe të tenderëve konkurrent, mendojmë dhe besojmë se AK nuk ka vepruar aspak në përputhje me nenin 59 të LPP-së kur ka bërë vlerësimin e tenderëve dhe kur e ka shpallur fitues OE Profitech SHPK. Pra në bazë të kësaj dhe në mungesë të dëshmive që nuk kemi pas mundësi të i shohim, dyshojmë se AK e ka shkelur nenin 59 të LPP-së.

Vlen të ju informojmë për faktin faktin se ne iu kemi drejtuar edhe Gjykatës Komerciale lidhur me refuzimin e ankesës tonë me nr. 2023/0859 përmes vendimit të OSHP-së të datës 09.11.2023. Kundër këtij veprimi, Gjykata kompetente e ka aprovuar masën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të OSHP-së që nënkupton se procesi i prokurimit duhet të ndërpritet (pezullohet) deri në vendimin përfundimtarë të gjykatës. Deri tani nuk kemi marrur ndonjë informatë se AK ose OSHP kanë marrë ndonjë vendim rreth kësaj andaj juve si OSHP ju kërkojmë që përmes një urdhërese ta detyroni AK-në që ta pezulloj aktivitetin e prokurimit deri në shqyrtimin kryesor të ankesës si dhe deri në vendimin përfundimtarë të gjykatës. Të gjitha dëshmitë e rrjedhës së procesit i gjeni të bashkangjitura kësaj Ankese."

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 7, 10, 11, 59 të LPP –së,. Duke propozuar qe të APROHOHET si e bazuar ankesa e OE N.P.T. "BOJKU HIDRAULIK" lidhur me tenderin "Furnizim me pjesë rezerve për autobusë IVECO" i iniciuar nga N.P.K. "TRAFIKU URBAN" SH.A.. të Anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK – N.P.K. "TRAFIKU URBAN" SH.A. ku pas rishikimit të komplet procedurës, për shkak të shkeljeve administrative të LPP-së të anulohet komplet procedura e prokurimit dhe lënda të Ri-Tenderohet. RI-TENDERIMI të bëhet në përputhje të plotë me LPP-në dhe rregulloret tjera të Prokurimit Publik.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtimte OE ankues:

Lidhur me pretendimin ankimor nga Operatori Ekonomik GAZMEND BOJKU 3.1 ju sqarojmë Kronologjinë e procedurës: Aktiviteti i prokurimit Furnizim me pjesë rezerve për autobusë IVECO me nr. te prokurimit: TU23-10152-1-1-1 dhe nr. te brendshëm: TU-23-017-111 është iniciuar nga data 26.09.2023 dhe operatoret ekonomik e interesuar kanë mundur te kërkojnë sqarime/kërkesa për rishqyrtim brenda afateve kohore të përcaktuara ne dosjen e tenderit. Me datën 10.11.2023 është dërgua lënda ne OSHP, lidhur me këtë vendimi i OSHP nr. 2023/0779 i datës 25.10.2023 i ka dhënë të drejtën Trafikut Urban për vazhdim te procedurave sepse ankesën tuaj e ka refuzua si te palejuar. Lidhur me këtë ne kemi vazhduar me procedura te prokurimit sipas ligjit ne fuqi, nuk kemi ndryshuar asnjë pike ne dosjen e tenderit dhe e kemi publikuar njoftimin për informata shtese vetëm për kohen e hapjes se ofertave. Pastaj hapja e ofertave është bere me datën 30.10.2023 ku ju keni ofertuar për këtë procedure duke mos ngarkuar asnjë dokument ne platforme të e-prokurimit dhe keni vendosur çmimi 1€ për te gjithë tenderin.

Ndërsa ju me datën 01.11.2023 keni dorëzuar ankesën ne OSHP dhe OSHP ne vendimin nr. 2023/0859 me datën 09.11.2023 ka refuzuar aneksen tuaj duke i dhënë te drejt "Trafikut Urban" për vazhdim të procedurave. Me datën 19.12.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e AK-se dhe ofertën Juaj (GAZMEND 30JKU B.l) është eliminuar për këto arsyeje: Ju si Operator Ekonomik nuk i plotësoni kërkesat administrative me saktësisht: Nuk keni dorëzuar formularin e përshkrimit te çmimeve ashtu siç duhet. Ju si Operator Ekonomik nuk i plotësoni kërkesat mbi mundësitë e Përshtatshmërisë profesionale me saktësisht:

Nuk keni dorëzuar Certifikatën e Numrit unik te biznesit, se bashku me përshkrimin e veprimtarisë primare dhe sekondare dhe Kopjen e Certifikatës TVSH-se. Nuk dorëzuar Autorizim nga Prodhuesit ose Dileri i Autorizuar nga Prodhuesi.Ju si Operator Ekonomik nuk i plotësoni kërkesat mbi gjendjen e Kapacitetit ekonomik dhe financiar me saktësisht: Nuk keni dorëzuar kërkesën /lidhur me qarkullimin financiar.Ju si Operator Ekonomik nuk i plotësoni kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale me saktësisht:

Nuk keni dorëzuar Listën e Kontratave me referenca. Nuk keni dorëzuar Deklaratën për afatin e /liferimit. Nuk keni dorëzuar kërkesat lidhur me stafin profesional.Pas kësaj situate ju si operator nuk jeni me pale e interesit sepse Oferta juaj nuk është serioze.

Pastaj, ju me datën 19.12.2023 keni bere kërkesë për qasje ne dokumente përmes e-mailit dhe Trafiku Urban me datën 20.12.2023 ju ka ftuar për qasje ne dokumente te kësaj procedure edhe pse ju nuk jeni pale e interesit dhe ju kemi treguar kërkesat për konfidencialitet te plotësuara nga Operatorët Ekonomik tjerë pjesëmarrës ne këtë aktivitet. Pastaj ju përsëri keni bere kërkesë për qasje ne dokumentet e tenderi dhe ne si AK edhe pse ju nuk jeni pale e interesit por për shkak te KORREKTÉSISË ju keni ftuar me datën 22.12.2023 në orën 09:00 dhe te keni qasje ne dokumentet e tenderit dhe ti shikoni ne forme fizike (qasje të pjesshme vetëm në shikim), MIRËPO ju nuk keni ardhur për qasje.

1.AK "TRAFIKU URBAN" ka respektuar nenin 7 të LPP ne përpikëri sepse kemi trajtuar operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe keni vepruar ne në mënyrë transparente.2.AK "TRAFIKU URBAN" ka respektuar nenin 10 të LPP-së ne përpikëri sepse është treguar transparent edhe ju është përgjigjur kërkesës tuaj për qasje ne dokumentet e tenderi edhe pse ju nuk jeni palë e interesit por për shkak te KORREKTÉSISË.3.AK "TRAFIKU URBAN" ka respektuar nenin 11 te LPP ne përpikëri sepse ka respektuar kërkesat për konfidencialitet te plotësuara nga Operatoreve tjerë ekonomik pjesëmarrës ne këtë aktivitet.4. AK "TRAFIKU URBAN" ka respektuar nenin 59 te I-PP sepse komisioni vlerësues ka bere Ekzaminimin, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve sipas LPP dhe kritereve te parapara ne dosjen e tenderit.

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 15/01/2024 ka autorizuar ekspertit shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0034/24, ndërsa me datë 26/01/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0034 me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të hedhet poshtë si e palejuar.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, pajtohet, ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Vlerësimi i eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0034, të pretendimeve ankimore të OE ankues "Gazmend Bojku" B.I, si në vijim;

"Sqarim Hyrës: Ankesa nr.34/23 ka të bëjë me të njëjtin aktivitet të prokurimit dhe është parashtruar nga i njëjti OE si në rastin e ankesës 859/23. Ankesa nr.859/23 nga OSHP është hedhur si palejuar, pasi OSHP ka konstatuar se OE "Bojku Hidraulik" kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së e ka parashtruar jashtë afateve ligjore të përcaktuara me LPP në fuqi dhe rregulloren për prokurim publik 001/2022.

Afati i fundit për ofertim fillimisht ka qenë data 11.10.2023, dhe kërkesa për rishqyrtim është dashtë të paraqitet 5 ditë para afatit të fundit për dorëzim të tenderit. Me rastin parashtrimit të një kërkese për rishqyrtim nga një OE tjetër dhe ankesës në OSHP nga i njëjti me nr.779/23, pas hedhjes të asaj ankese nga OSHP, AK me 26.10.2023 ka bërë shtyrjen e aftit për ofertim deri me 30.10.2023.

OE "Bojku Hidraulik" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me 28.10.2023, dhe pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim ka vazhduar me ankesë në OSHP me nr.859/23, e cila ankesë po ashtu është hedhur e palejuar për shkak të shkeljes së afatit ligjore për kërkesë në rishqyrtim. Sqarojmë se afati 5 ditorë para hapjes, kur kemi të bëjmë me ankesë në kritere, sipas nenit 60.1 pika a, të rregullave për prokurim publik, nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

Thënë ndryshe, përderisa nuk ka pasur ndryshime në kërkesat/kushtet e dosjes së tenderit, afati për kërkesë për rishqyrtim në kritere ka qenë 5 ditë para afatit për dorëzim të tenderëve i paraparë për datën 11.10.2023. Andaj konsiderojmë se nuk qëndron pretendimi i OE ankues se nuk ka pas kohë të mjaftueshëm për përgatitjen e ofertës, pasi kriteret e dosjes kanë qenë të ditura qysh nga 25.09.2023, e jo nga 26.10.2023 kur është bërë vazhdimi i afatit për ofertim pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim.

Megjithatë, pas gjitha këtyre ngjarjeve dhe pas hapjes së ofertave, AK ka pranuar vendim nga Gjykata Komerciale për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të OSHP-së nr.859/23. Meqenëse hapja e ofertave (që nënkupton ekzekutimin e vendimit të OSHP-së 859/23) si dhe njoftimi mbi vendimin e AK-së, janë bërë para se AK të pranoj vendim nga gjykata për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të OSHP-së 859/23, AK nuk ka pas se si të bëjë shtyrjen e ekzekutimit të vendimit 859/23 pasi ai vendim veç se është ekzekutuar. Konsiderojmë se i mbetet panelit shqyrtues të OSHP-së të merr parasysh gjitha këto që u cekën më lart, në veçanti vendimin e Gjykatës Komerciale me numër KA nr.559/23 para marrjes së vendimit.

Pretendimi nr.1: "Pretendimet kryesor te OE ankues kanë sipas ankesës nr.34/24 ka të bëjë me dhënien e qasjes në dokumente të OE të rekomanduar për kontratë. OE pretendon se nuk i është dhënë qasja në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, e po ashtu pretendon se pika 11.3.1 dhe pika 11.3.3 nuk janë plotësuar nga kërkesa për sekret afarist e dërguar nga OE Profitech SHPK dhe përpos kësaj, sipas OE ankues kërkesa përmban edhe dokumente që nuk bien tek nenin 68 dhe 69 i LPP-së. Parimisht pajtohemi me konstatimet e OE ankues, në kuptimin e asaj që çdo OE me rastin e dorëzimit të kërkesës për sekret afarist duhet të argumentoj arsyet, që bindshëm demonstrojnë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit

kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik. AK po ashtu ka mund të përgatis vizionin e pastruar të dokumenteve ashtu siq parashihet me dispozitat e nenit 11 par.4 të LPP-së. Sido që të jetë, OE ankues nuk e konteston asnjë nga 7 pikat AK-së për eliminimin e tij. OE ankues nuk e dëshmon dhe as nuk tenton të dëshmoj se në çfarëdo rrethane i njëjti mund të jetë fitues i këtij tenderit, duke ofruar kundër argumente në arsyet e eliminimit të tij nga AK, mirëpo kërkon anulimin e tërësishëm të aktivitetit të prokurimit.

Në këto rrethana konsiderojmë se OE nuk ka dëshmuar se është Palë me interes siq parashihet me LPP. Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar Bazuar në këto që u cekën më lart, vlerësojmë se pretendimet ankimore janë vetëm pjesërisht të bazuara sa i përket qasjes në dokumente zyrtare, mirëpo jo edhe pretendimet dhe kërkesa për anulimin e aktivitetit të prokurimit, për shkak të arsyeve të cekura si më lart. Meqenëse kemi një vendim të Gjykatës Komerciale për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të OSHP-së nr.859/23 (vendim i OSHP-se i cili sipas mendimit tonë veç se është ekzekutuar nga AK), i mbetet paneli shqyrtues të marr vendim final lidhur me veprimet e mëtutjeshme që duhet të ndërmerren nga AK."

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, janë vlerësuar si pjesërisht të bazuara vetëm sa i

përket qasjes në dokumente zyrtare, mirëpo jo edhe pretendimet dhe kërkesa për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Paneli Shqyrtues bazuar në të gjeturat e ekspertit shqyrtues, konsideron se ankuesi nuk ka arritur të dëshmoj me prova konkrete se ka pasur shkelje ligjore nga ana e Autoritetit Kontraktues gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit në fjalë. Andaj Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pjesë rezerve për autobusë IVECO", me numër të prokurimit TU-23-10152-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A.Prishtinë. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të refuzuar ankesën e Operatorit Ekonomik "Gazmend Bojku" B.I, kundër Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE "Profitech SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit, TU-23-10152-1-1-1.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertes shqyrtuese, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se vetem pretendimi ankimor sa i perket casjes në dokumnete publike është pjeserisht i bazuar, ndërsa pretendimeve tjera sa i perket anulimit të aktivitetit të prokurimit jane të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet refuzohet si pabazuar, çështje e gjykuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur qe ankesa e OE refuzohet si ceshtje e gjykuar sepse i njëjti nuk ka dëshmuar se kemi të bëjme me një aktivitet tjeter të prokurimit.

Paneli shqyrtues konstaton se OE ankues nuk i ka kontestuar asnjë nga 7 pikat e Autoritetit kontraktues për eliminimin e tij në kët aktivitet prokurimi. OE ankues nuk ka arrtur të dëshmon se i plotëson kërkesat e Dosjes së tenderit, që ai mund të jetë fitues i këtij tenderit, duke ofruar kundër argumente, në arsyet e eliminimit të tij nga AK, mirëpo kërkon anulimin e tërësishëm të aktivitetit të prokurimit. Paneli konstaton se në këto rrethana OE ankues nuk ka dëshmuar se është Palë me interes siq parashihet me LPP. Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar Bazuar në këto që u cekën më lart, vlerësojmë se pretendimet ankimore janë vetëm pjesërisht të bazuara sa i përket qasjes në dokumente zyrtare, mirëpo jo edhe pretendimet dhe kërkesa për anulimin e aktivitetit të prokurimit, për shkak të arsyeve të cekura si më lart.

Paneli shqyrtues sa i përket çasjes në dokumnete të operatorve ekonomik ofertues të cilat janë klasifikuar nga OE si informata sekrete afariste sipas nenit 11 i LPP-së, paragrafi 3 që përcakton: "Autoriteti kontraktues mund t'i klasifikojë informatat e tjera si informatë sekrete afariste vetëm nëse informata përkatëse i përmbushë këto tri kritere sipas ligjit...", në kët rast Paneli tërheqë vëmendjen Autoritetit kontraktues për obligimin ligjor të tyre, se në rastet e dokumenteve konfideciale AK-të janë të obliguara të bëjnë spastrimin e teksitit te dokumentit dhe tja ofrojnë palëve kërkuese. Po ashtu lidhur me ket rast Paneli vrenë se nga dokumnetet e rastit AK më datën, 22.12.2024, e ka ftuar ankuesin për çasje në dokumnete, por ai nuk ka shkuar.

Paneli shqyrtues bazuar në argumentet e larteshneuara konstaton se OE ankues me veprimet e tij zvarrit vendimarrjen e ketij aktiviteti të prokurimit kundrejt, Autoriteti kontraktues dhe OE-ve ofertues në kët aktivitet te prokurimit, derisa vete ankuesi nuk ka arrtiur të dëshmojne me argumente se është pale e përgjegjeshme dhe plotson kërkesat e Dosjes së tenderit, andaj dhe ankesa e tije është e pabazuar.

Paneli shqyrtues vrenë se lidhur me këtë aktiviteti të prokurimit OE ankues, me parë ka paraqit ankesë në OSHP dhe Paneli shqyrtues me vendimin nr; 859/2023,datës,09.12.2023, e ka hudhur

posht si të palejuar (jashtafatshme) ankesën e OE ankues“Gazmend Bojku” B.I, kundër aktivitetit prokurimit “Furnizim me pjesë rezerve për autobusë IVECO”, me numër të prokurimit TU-23-10152-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A.Prishtinë.

OE ankues“Gazmend Bojku” B.I, kundër vendimit të OSHP nr.859/2023,datës, 09.12.2023, ka paraqit padi në Gjykaten Komerciale –Depratementi Administrative, e cila me Aktvendimin 559/23, datës 12.12.2023, e miraton propozimin për mase të përkohshme të ankuesit për shtyerjen e ekzekutimit të vendimit në fjalë. Ndërsa OSHP paraqet ankesë ndaj vendimit të gjykatës në fjale në, Dhomën e shkalles së dytë të Gjykatës Komerciale, e cila me Aktvendimin nr.247/2024, datës, 31.01.2024, e miraton ankesën e OSHP-se dhe e anulon Aktvendimin e gjykatës së Dhomës së shkalles së parë.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankese të OE, vendosi të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **N.P.K. " TRAFIKU URBAN " SH.A.**
- OE - **Gazmend Bojku B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: